




Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____ Nr. Prot. _____
 Dep. 2-D/DPK Br. Prot. 01-604/16
 Nr. I faq. _____ Prot No. _____
 Broj stranica 03 Datum 15.02.2016
 Nr. pages _____ Date _____

PRISTINE



DATË/A:	15.02.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/524/16
PËR/ZA/TO:	z. Salih KQIKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Komunën e Gjilanit
CC:	z. Lutfi HAZIRI Kryetar i Komunës së Gjilanit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Ndërtimi i çerdhes-Institucionit parashkollor në lagjen Dardania 1 Gjilan "

I nderuari z. Kqiku ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Ndërtimi i çerdhes (Institucionit parashkollor) në lagjen Dardania 1 - Gjilan " me numër prokurimi Gi651-16-003-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " ***Ndërtimi i çerdhes (Institucionit parashkollor) në lagjen Dardania 1 - Gjilan*** " me numër prokurimi Gi651-16-003-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit Nr.04/L-042, për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 08.02.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-3-524/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Ndërtimi i çerdhes (Institucionit parashkollor) në lagjen Dardania 1 - Gjilan*" me numër prokurimi Gi651-16-003-521, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit.

Agjencia kundër Korrupsionit duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.28.01.2016, ku Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit punë me vlerë të madhe të kontratës.

Duke u bazuar në dokumentet zyrtare të cilat janë pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit, Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit ka lidhur Marrëveshje mirëkuptimi me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për zhvillim ndërkombëtar USAID ku janë paraparë 200,000.00 \$ participim nga USAID në formë të grantit, ndërsa pjesën tjetër të fondeve është obliguar që t'i siguroj Komuna e Gjilanit.

Gjatë analizimit të dosjes së këtij tenderi e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia kundër Korrupsionit ka vërejtur se tek pika 9.1 e rubrikës kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kërkesa *1. janë kërkuar referenca për punë të ngjajshme në ndërtim të lartë në tri vitet e fundit minimum tri (3), secila prej tyre në vlerë mbi 100,000.00 €, kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.*

Sipas këtij Ligji për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë vlera minimale referenca në lidhje me punët ndërtimore në 3 vitet e fundit përmes një liste që specifikon secilin nga projektet punuese të Operatorëve ekonomik dhe aktiviteteve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellë me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punues dhe/ose aktiviteteve të ndërtimit. Por nuk është e lejuar që të kërkojnë projekte duke e caktuar edhe vlerën e projekteve të realizuara veç e veç si në rastin konkret. Nëse Autoriteti kontraktues ka për synim që ta vërtetojë qarkullimin minimal financiar të realizuar përmes kontratave atëherë duhet që të kërkojë vlerën e përgjithshme monetare të punëve të realizuara në tri vitet e fundit e jo të kërkojnë kontrata me referenca në vlerat e caktuara si më lartë. Për më tepër kur përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara me kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm të ekonomik e teknik-profesional.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen dhe të përsëriten në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

